



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 12, 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 e datës 04 qershor 2008, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 8 paragrafi 1 pika 1.2 dhe nenit 14 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019, nenit 13 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës të datës 13.08.2020 dhe nenit 9, 17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 29.03.2024, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

V E N D I M

PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS ZK-GRACKË E VJETËR

Neni 1

1. Me këtë Vendim jepet në shfrytëzim afatgjatë personave fizik dhe juridik paluajtshmeria-prona komunale që gjendet në Zonën Kadastrale Grackë e Vjetër të përshkruar si në vijim:

Njësia kadastrale P-71409080-00007-0 me sipërfaqe prej 21715 m² në Zonën Kadastrale Grackë e Vjetër, Komuna Lipjan.

Neni 2

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës komunale destinohet kryesisht për ndërtimin e objekteve banesore për kategoritë e dalura nga lufta e UÇK-së nga Komuna e Lipjanit konform Vendimit 1Nr.351-668 datë 13.10.2008 të miratuar të Kuvendit Komunal për shpalljen e interesit të përgjithshëm në ZK - Grackë e Vjetër për kategoritë e daluara nga lufta e UÇK-së nga Komuna e Lipjanit dhe Vendimit të Kuvendit Komunal Nr.15-463/02-27912 të datës 31.05.2023 për ndryshimin e Vendimit 1Nr.351-668 të datës 13.10.2008 për kategoritë e daluara nga lufta e UÇK-së nga Komuna e Lipjanit.

Prona komunale për shfrytëzim sipas nenit 1 të këtij vendimi i përket zonës së planifikuar për ndërtim të lartë banesor i kombinuar me afarizëm sipas kushteve të përcaktuara me Hartën Zonale të Komunës së Lipjanit. Sipas Hartës Zonale të Komunës kjo parcelë është e shtrirë në ZB6 me etazhitet B=P+3.

Neni 3

Prona komunale sipas nenit 1 të këtij Vendimi jepen në shfrytëzim afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite nëpërmjet procedurës së Njoftimit publik nga ana e Komisionit Vlerësues sipas Vendimit të Kuvendit Komunal.

Neni 4

Procedura e dhënies në shfrytëzim të pronës të komunës të përcaktuar në nenin 1 të këtij Vendimi bëhet përmes "Shprehjes së Interesit", duke i plotësuar edhe kriteret tjera të përcaktuara me nenin 5 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Neni 5

Zgjedhja e ofertës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës të paluajtshme të komunës, bazohet në kriteret e përcaktuara në nenin 20 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës përmes "Shprehjes së Interesit".

Neni 6

Obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër që pas përfundimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës të paluajtshme të komunës sipas nenit 1 të këtij Vendimi të regjistroj në librat kadastral si pronë të dhënë në shfrytëzim në afat prej 99 vitesh sipas procedurave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Neni 7

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori Pronëso- Juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtorati për Inspektion.

Neni 8

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

15 Nr. 463/02-17203

Lipjan, më 29.03.2024

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

